DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-586/21
-VI-
Datë 01.06.2018

# Republika Kosovo - Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Shkelqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL | Datë: 29/05 /2018 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës se Gllogocit | Nr. 020-586 |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi nr.421/01/27090 për shfuqizimin e vendimit nr. 421-3587 të datës 19.06.2009 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NTP "FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga komorani; |
| I miratuar më datë: 04.05.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 14.05.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi***. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim. Vendimi dhe ky vlerësim nuk mohojnë të drejtën e palëve të pakënaqura për pretendime që dalin nga kontrata për të drejta dhe detyrime, konteste këto që duhet të zgjidhen nga gjykata ashtu siç është përcaktuar me kontratë.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-586/21 -VI-
Data Datum Date 01.06.2018

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Ramiz Lladrovci, gradonačelnik Opštine Glogovac<br>Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Cc: | Jednici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jednici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MALS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a | |
| Od: | Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština- MALS | Datum, 29/05 /2018 Br. 020-586 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine | |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obaveznu rapsravu zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-40 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br.421/01/27090 o ukidanju Odluke br.421-3587 od dana, 19.06.2009. godine, za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine NTP "FLORIANI" sa vlasnikom Muhamet Ajazi iz Komorana |
| Usvojena dana, 04.05.2018. godine, |
| Predložena za razmetranje u MALS-u dana, 14.05.2018. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministartsvo administracije lokaklne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije
Ministry of Local Government Administration
14.05.2018
-01-020-5316

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Kuvendi i Komunës

**12 Nr 421/01-27380 dt. 11/05/ 2018**

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34,6 të Statutit te Komunës së Drenasit, nenit 110 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-942/04-21953 të datës 18.04.2018 të komisionit profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, për pronën komunale gjegjësisht ngastrën kadastrale Nr.1/2 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, NTP "Floriani" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 04.05.2018 2018 aprovoi këtë:

# VENDIM

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 421-3587 TË DATËS 19.06.2009, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM NTP "FLORIANI" ME PRONAR MUHAMET AJAZI NGA KOMORANI**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Komoran, që i ishte dhenë në shfrytëzim NTP."FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani, në ngastrën kadastrale Nr.1/2 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, në shfrytëzim të përkohshëm për 10 vite .

**Neni 2**

Shfuqizohet Vendimi Nr.421-3587 i datës 19.06.2009 i komisionit për dhënie ne shfrytëzim të përkohshëm te pronës komunale, me bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 462-4010 e datës 06.07.2009, me të cilat vendim i është dhenë prona komunale në shfrytëzim NTP."FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani, ngastrën kadastrale Nr.1/2 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran.

**Neni 3**

Me kete vendim do te njoftohet NTP."FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani.

**Neni 4**

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

**Neni 5**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

Labinot Halilaj

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**01 Nr** 030-30157 **dt.** 25.05. **2018**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 25.05.2018 |
| **PËR/ZA/TO:** | z. Xhevat Tafa, Udheheqes i Divisionit per Monitorimin e Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, |
| **NGA/OD/FROM:** | Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit, |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Dërgimi i informacionit të kërkuar me datën 21 Maj 2018, |

Me aktin e JUAJ të datës 21 Maj 2018, keni kërkuar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit, dokumentacionin shtesë sipas këtij akti me rastin e vlerësimit të detyrueshëm të ligjshmërisë në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të akteve të nxjerrur nga Kuvendi i Komunës e atë të Vendimit Nr.421-3587 të datës 04.05.2018 për shfuqizimin e Vendimit nr.421-3587 të datës 19.06.2009 dhe Vendimit nr.42/01-27090 i datës 04.05.2018 për shfuqizimin e Vendimit nr.421-3587 të datës 19.06.2019.

Mbi këtë bazë ju informojmë si vijon:
Me rastin e dhënies së këtyre paluajtshmerive në shfrytëzim në afat të caktuar përfituesve sipas Vendimit Nr.421-3587 të datës 19.06.2009,nuk ka pas ligj që e ka rregulluar këtë çështje sepse të dy Ligjet që rregullojnë këtë çështje e atë Ligji Nr.03/L-326/2010 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale dhe këmbim si dhe Ligji Nr.04/L-144/2012 kanë hyrë në fuqi pas dhënies së këtyre paluajtshmërive përfituesve në kuptim të Vendimit të Komisionit Nr.421-3587 të datës 19.06.2009,i cili Vendim është nxjerrë në kuptim të Rregullores për Procedurat dhe Kriteret e dhënies së tokës Komunale në Shfrytëzim të përkohshëm me numër 012 Nr.351-183 të datës 31.12.2004.

Meçe këtë Vendim nuk e ka nxjerr Kryetari i Komunës e as Kuvendi i Komunës nuk është dërguar tek JU për vlerësimin e ligjshmërisë sepse në kuptim të nenit 80 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, vlerësimi i ligjshmërisë nga Ministria përkatëse behet vetëm për aktet që i nxjerrë Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës e jo të Komisioneve të ndryshme që funksionojnë në kuadër të Komunës.

Meçe me rastin e dhënies në shfrytëzim të këtyre paluajtshmerive në vitin 2009 nuk kanë qenë në fuqi të dy ligjet që rregullojnë këtë materie e që konsiderohen si ligje të veçanta e të njëjtat kanë munguar,është aplikuar Ligji Nr.42/86 i nxjerrur në vitin 1986 mbi tokën Ndërtimor si ligj i aplikueshëm sipas Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut, Nr.25/99.

Me dispozitat e nenit 20 të këtij Ligji është paraparë së nëse personat të cilët e fitojnë në shfrytëzim parcelën ndërtimore janë të detyruar që në afat prej tri vitesh prej ditës së marrjës në dorëzim të Vendimit ta ndërtojnë ndërtesën respektivisht t'i kryejnë punët e konsiderueshme ndërtimore. Nëse në afatin e caktuar nga pika tre të këtij neni nuk ndërton ose nuk e kryen punën e konsiderueshme humb të drejtën e përparësisë së ndërtimit nën kushtet dhe mënyrën e caktuar me Vendim.

Po ashtu edhe më nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të Kontratës mbi dhënien e tokës komunale në shfrytëzim të përkohshëm është paraparë që përfituesi është i obliguar që të filloj punën për ndërtimin e objektit në afatin prej tre muajsh dhe të përfundon brenda një viti, në të kundërtën humbë të drejtën e shfrytëzimit të kësaj paluajtshmërie.

Këta përfitues nuk kanë ndërtuar objektet në afatet e parapara por akoma edhe pas nëntë (9) vitesh, nuk i kanë realizuar detyrimet nga Kontrata, rrjedhimisht Kuvendi ka Marrë Vendimi që këto parcela ndërtimore t'i kthehen pronarit e atë Komunës së Gllogocit.

Këto Dy Vendime të Kuvendit të Komunës janë si bazë juridike që prona Komunale të regjistrohet në emër të Komunës në Regjistrin Kadastral Komunal që e mbanë Zyra Kadastrale Komunale përkatësisht në RDPP duke i çregjistruar përfituesit e përkohshëm nga ky regjistër së për të qenë një punë juridikisht e vlefshme duhet te këtë bazën juridike në mungesë të vendimit të Kuvendit të komunës nuk mund të azhurnohet në regjistrin kadastral.

Mbi këto baza ju informojmë së Kuvendi i Komunës këtë dy Vendimi që do të vlerësohen nga JU janë marrë duke u bazuar në faktin së përfituesit e këtyre parcelave nuk i kanë kryer detyrimet e dala nga Kontrata e lidhur në mes përfituesve dhe Komunës dhe nga ky fakt këto kontrata konsiderohen si NUL dhe nuk kanë prodhuar kurrfarë efekti juridik.

Bashkangjitur kësaj shkrese ju dërgojmë edhe dokumentacionin e kërkuar e atë me dokumentacion që disponojmë.

Me respekt!

18 / 041 2018

01 942/04 - 21953

Duke e zbatuar vendimin e zyrës se Kryetarit të Komunës se Drenasit 01.nr.020-18040 të dt. 30.03.2018 me të cilin vendim është formuar komision professional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënjes se në shfrytëzim të pronave komunale.Komisioni në perberje të plotë pas verifikimit të procedurave administrative-ligjore paraqet këtë:

# RAPORT

## MBI VLERSIMIN E ZBATUESHMERISË SE PROCEDURAVE LIGJORE PËR DHËNJEN E PRONAVE KOMUNALE NË SHFRYTËZIM DHE PERMBUSHJËS SE OBLIGIMEVE KONTRAKTUESE

Komisioni në përberje të plotë ka filluar me punë me datë:03.04.2018 rreth vlersimit të procedurave për dhënjen e pronave komunale në shfrytëzim dhe zbatueshmerisë se kontratave të lidhura në mes të Komunës se Drenasit gjegjësisht Kryetarit të dhe atyre të cilët e kan marr pronën komunale në shfrytëzim , Komisioni duke berë një punë efikase në terën dhe në zyre për secilin rast veq e veq ka rezultuar me këto të dhëna në raport me shkrim.

Në zonën kadastrale në Komoranë ka verifikuar rastet si:

I. Kontratën për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim në mes të Komunës se Drenasit dhe NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gzim Gegaj nga Komorani e protokoluar nen numrin e protokolit 421-6064 të datës 06.07.2009

Në kontratë shifet se është e nenshkruar nga ish Kryetari I Komunës se Drenasit z. Nexhat Demaku dhe pronari I firmes Gzim Gegaj.

Komuna sipas komntratës se shenuar me lartë i ka dhenë në shfrytëzim pronën komunale gjegjësisht pjesët e ngastrës kad. Nr.202 dhe 201 me kulturë tokë ndertimore në siperfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran.në kohëzgjatje të shfrytëzimit prej 10 vitësh.

Sipas kontratës Gezim Gegaj ka pas për obligim ndertimin e objektit mbrenda një viti për punë në veporimtarin për të cilën e ka marr edhe tokën në shfrytëzim

Sipas kontratës pronari Gezim Gegaj ka pas për obligim që të I paguaj komunës qeran në shumë vjetore 8000 euro në qdo fund vit.

Sipas të dhenave në Operat kadastral kjo kontratë nuk është e rexhistruar fare në RDPP,pastaj sipas të dhënave nga Drejtorati për financa ,Gëzim Gegaj nuk ka paguar asnjëherë obligimet të cilat i ka pas sipas kontratës. Ndaj Komunës.

Në tëren nga ekspertet e gjeodezisë janë berë matjet gjeodezike dhe nga ana e komisioni komunal shifet se është i ndertuar vetem një object i thjesht në të cilin punuohet per dyr e dritare plastike,dhe një pjesë aneks në të cilin është një autolarje,(me një pjesë të vogel uzurpimi të rrugës S=0.00.23 ha dhe një siperfaqe toksore e mbushur sipas pronarit për fushë sportive por e pa perfunduar.
Nuk ka kurfar leje të ndertimit pë ate vend ku zhvillon veprimtarin.
Nga komisioni konstatohët se pronari I kësaj firme e nuk i ka permbush obligimet kontraktuese sipas kontratës ndaj Komunës se Drenasit në asnjë aspect prandaj i rekomandon zyrës se Kryetarit të Komunës që në harmoni me ligjet në fuqi të ndermarr masat e duhura për anulimin e kësaj kontrate dhe që ta obligoj pronarin që siperfaqën e pronës komunale të cilën e ka marr në shfrytëzim ta kthej në gjendjën e meparshme dhe ta liroj mbrenda afatit prej 60 ditësh.

II .Kontrata për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim e lidhur në mes të ish kryetarit të Komunës se Drenasit z.nexhat Demakut dhe pronarit të firmës NTP"Floriani" Muhamet Ajazit e protokoluar nen numrin 462-4010 me dt. 06.07.2009

Me këtë kontratë i është dhën në shfrytëzim prona komunale Muhamet Ajazit nga Komoran gjegjësisht ngastra kadastrale nr. 1/6 me kulturë tokë ndertimore në siperfaqe prej S=0.10.00 ha
Zona kadastrale Komoran në shfrytëzim për 10 vite.
Pas inqizimit gjeodezik nga ekspertet dhe verifikimit nga ana e komisioni professional të komunës në teren shifet se Muhamet Ajazi ka ndertuar një object perdhes dhe nuk ka vazhduar më tejë.Nuk ka as leje ndertimi dhe inspeksioni ka intervenuar për nderprerje të punimeve në object përderisa ska leje ndertimi.Gjithashtu konstatoohët se në hyrje të ngastres ka edhe një pjesë uzurpimi në siperfaqe prej S=0.00.71 ha.
Sipas të dhënave nga Drejtorati për financa del se I permenduri I ka kryer obligimet financiare ndaj komunës deri në viti 2017,gjersa në kontrat shkruan se obligohët të ia paguaj nga 2000 euro per qdo vit kalendarik Komunës.

Sipas kontratës I permenduri është dashur ta perfundoj objektin për të cilin ka deklaruar se po e benë për afarizëm,por fatkeqsisht nuk e ka ndertuar mbrenda afatit (për një vit).

Rexhistrimin në RDPP e ka berë dhe e ka Qertifikatën mbi të drejtat e shfrytzimit të pronës komunale.
Nga komisioni konstatohët se pronari I kësaj firme e nuk i ka permbush obligimet kontraktuese sipas kontratës ndaj Komunës se Drenasit në asnjë aspect prandaj I rekomandon zyrës se Kryetarit të Komunës që në harmoni me ligjet në fuqi të ndermarr masat e duhura për anulimin e kësaj kontrate dhe që ta obligoj pronarin që siperfaqën e pronës komunale të cilën e ka marr në shfrytëzim ta kthej në gjendjën e meparshme dhe ta liroj mbrenda afatit prej 60 ditësh.

Gjithashtu komisioni konstatoj nga raporti i meparshem të protokoluar 01.nr.463/15202 të datës 15.03.2018 se janë edhe dy raste tjera të dhënjes se pronës komunale në shfrytëzim peersonave fizik si:Hajdar Hetës dhe Zenë Strumcakut -Qazim Goranit sipas tekstit në vijim.

III. Komisioni vazhdoi me trajtimin e procedurave ligjore dhe dokumentacionit për ngastrat kadastrale nr. 98/3 dhe 98/4 të zona kadastrale Qikatova e Re.

-Në dokumentacionin e fotokopiuar për ngastrën kadastrale nr.98/3 kemi Aktvendimin 07.nr.353/180/1 të dt.14.10.1992 (vendim I masave të dhunshme të Serbisë)me të cilin I është dhenë prona komunale (për ndertim individual të objektit) në siperfaqe prej s=0.04.00 ha në Z. kad. Qikatova e Re.Zejnullah Strumcakut ngaq fshati Abri e Epër.

-Pastaj Kontrata për shitblerjën e këtij trolli në siperfaqe prej S=0.04.00 ha e lidhur në mes të Zejnullah Strumcakut (shitës) dhe Qazim Goranit nga Pokleku (blerës) e cila kontratë edhe është e vertetuar në Gjykatën komunale në Prishtinë nen numrin 1654 të dt. 14.08.2000

-Aktvendimi I Drejtoratit për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë I Komunës se Drenasit nr.952/26 I dt. 08.03.2005, me të cilin aktvendim I është refuzuar kerkesa për rexhistrim në RDPP të këtijë truelli,me arsyetim se nuk ka pasur të drejt të tjetersimit të pronës nga Zejnullah Strumcaku në emer të Qazim Goranit.

- Aktvendimin nr.03/224/09 të dt.29.04.2009 me të cilin AKK Ja në Prishtinë ia aprovon ankesën dhe e detyron Drejtorinë për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë të Komunës se Drenasit që ta rexhistron ketë truallnë emer të Qazim Goranit.

- Pasi që Komuna nuk e ka zbatuar detyrimin për regjistrim të asaj ngastre-trualli,AKK në Prishtinë me Aktvendimin nr. 03/824/09 të dt. 02.02.2011 ka berë ekzekutimin e aktvendimit të vetë me nr. 03/224/09 të dt. 29.04.2009 dhe e ka rexhistruar vetë drejtperdejt truallin në emer të Qazim Goranit nga Pokleku nga Pokleku.

-Me vonë Drejtorati për kadaster Gjeodezi dhe Pronë I Komunës se Drenasit ka berë azhurimin e në RDPP me datë 15.07.2015 dhe e ka leshuar Qertifikatën mbi të drejtat e pronës se paluajtshme dhe ate si (lloj I pronës -pronë private ) në emer të Qazim Goranit dhe aty ku është I shenuar emri, është shfrytëzues I perhershem.

Komisioni konstaton se procedura administrative ka parregullsi dhe përkunder asaj që Drejtorati për kad. Gjeod. dhe pronë ia ka refuzuar kerkesën për rexhistrim në RDPP.

Kur themi se ka parregullsi, vejmë në pah se ngastra kadastrale e shenuar në emer të Qazim Goranit nuk ka mundur të tjetersohët nga Zejnullah Strumcaku si shitës.

Prap edhe pse AKK në Prishtinë e ka futur në system na nuk mund ta hjekim nga sistemi por I permenduri sipas dispozitave në arsyetim të Aktvendimit të ZKK-Drenas del se e ka humbur të drejtën e ndertimit ngase ate kusht të ndertimit është dashur ta permbush mbrenda tri vitesh.

Ndersa të rexhistrimi I ngastrës kadastrale nr. 98/4 në emer të Hajdar Hetës komisioni gjatë procedimit të kësaj lënde trajtoj komplet dokumentacionin që nga fillimi duke vlersuar procedurën e ndarjës dhe rexhistrimit në RDPP të ngastrës kad. Nr. 98/4.

-Komisioni në fillim konstatoi se kjo ngastër kadastrla me aktvendimin 07.nr.353-142 të dt. 30.04.1993 I është ndar në shfrytëzim të perhershem ngastra kad. Nr. 98/4 në siperfaqe prej S=0.04.50 ha e shenuar më lartë Hajdar Hetës nga Drenasi (në kohën e masave të dhunshme të Serbisë).

Me vonë me aktvendimin 07.nr.351-209 të dt. 12.07.1993 I ipet leja për ndertimin e objektit në ate vend gjegjësisht në truallin-ngastrën kad. Nr.98/4 në Qikatovë të Re.

-Mer aktvendimin nr.,952/290 të dt. 19.10.2005 nga Drejtorati për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë I rrefuzohët kerkesa për rexhistrimin e këtijë trualli në emer të Hajdar Hetës.

-Hajdar Heta ka vazhduar me ankesë në AKK në Prishtinë dhe AKK-ja me konkluzionin nr.03/879/09 të dt.879/09 të dt.1.07.09 e urdhëron Drejtoratin për Kad. Gjeod. dhe Pronë që ta vendos kerkesën e Hajdar Hetës në procedurë ligjore.

-Me Aktgjykimin e Gjykatës themelore në Prishtinë –departamenti për qeshtje administrative nr. 986/2009 të dt. 11.06.2013 është rrefuzuar kerkesëpadia e Komunës se Drenasit e cila e ka paditur AKK-n në Prishtinë për ketë regjistrim të kësaj pronë.

-Pas rexhistrimit në RDPP të kësaj prone në emer të Hajdar Hetës nga Drenasi, me Qertifikatën mbi të drejtat e pronës se paluajtshme të azhuruar me datë 15.07.2015 e ka nxjerr nga Drejtorati për kad. Gjeod. dhe Pronë Qertifikata e pronës në emer të Hajdar Hetës jo si shfrytëzues I perhershem I pronës komunale por si lloj I pronës privat.

Komisioni konstaton se procedura administrative lidhur me ketë ngaster kadastrale ka parregullsi edhe pse Drejtorati për kadaster gjeodezi dhe Pronë ia ka rrefuzuar rexhistrimin e pronës se H.Hetës në RDPP.

Kur themi se ka parregullsi rreth zbatimit të ligjshmerisë për ketë truall nga se Hajdar Heta e ka marr në kohën e masave të dhunshm, edhe Lejën e ndertimit të objektir ,por I njejti nuk ka ndertuar kurr,e që është në kundershtim me ligj sepse pas kalimit të afatit prej tre vjetesh nese nuk ka berë ndertim në ate vend e ka humbur të drejtën e ndertimit (kur edhe e ka pas lejen e ndertimit nga organi I dhunshem).por që nuk e ka shfrytëzuar.

**Komisioni konstaton se pronat e dhëna në shfrytëzim të perhershem për Hajdar Hetën dhe Zenë Strimcakun e që me von është berë edhe tjetersimi i pronës komunale nga Zenë Strimcaku të Qazim Gorani,ka shkelje të dispozitave ligjore,andaj komisioni lidhur me parregullsit e rexhistrimit të ngastrës nr.98/3 dhe 98/4 z.kad.Qikatovë e Re I rekomandon zyrës se Kryetarit që të ndermerr veprimet ligjore për kthimin e e ketyre dy ngastrave kadastrale në emer të Komunës se Drenasit.**

DRENAS :18.04.2018

KOMISIONI:1.Halim Prokshi________

2.Ibrahim Hajdari________

3.Safet Hoxha________

4.Flora Thaqi________

5.Enver Hoxha________

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : N.T.P "F l o r j a n i I"

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 464-01-27865 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 25.05.2018 - 15:12 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name | Emri Ime First Name | Emri i babait Ime oca Father's Name | Gjinia Pol Gender | Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| N.T.P "F l o r j a n i I" | | | / / | 80243812 | KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO | 11.08.2000 | 27.04.2017 | |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi Prebivalište Resident | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Adresa tjetër Druga adresa Other address | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| KOMORAN / KOMORANE / KAMARAN | | " Komoran " | KOMORAN | |

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIKA KOSOVO · OPŠTINA GLOGOVAC · REPUBLIC OF KOSOVO · GLLOGOC MUNICIPALITY

## E. TË DREJTAT E SHFRYTËZIMIT - PRAVA NA KORIŠĆENJE - RIGHTS OF USE

| Lloji i së drejtës<br>Vrsta prava<br>Type of the right | Nr i Njësisë kadastrale<br>Br. Katastarske jedince<br>Cadastral Unit no | Zona Kadastrale<br>Katastarska<br>Zona Cadastral Zone | Shfrytëzuesi<br>Korisnik<br>User | Lloji i njësisë<br>Vrsta jedinice<br>Unit type | Lloji i së drejtës të shfrytëzimit<br>Vrsta prava korišćenja<br>Type of right use | Komentet tjera/<br>Ostali komentari/<br>Other comments | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa<br>Aktuelna upotreba/<br>Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| E drejta e shfrytëzimit / Pravo Na Koriscenje / Right of use | P-70314035-00001-6 | KOMORAN / KOMORANE / KAMARAN | N.T.P "F l o r j a n i I" | parcelë / parcela / parcel | E drejat e shfrytëzimit të ndërtesës / Pravo Na Koriscenje Zgrade / Right of use for building | 15-2009 | 1000 | Tokë Ndërtimore-Truall- / Gradjevinsko zemljište-Zemliste- / Construction land-Land - | 27.04.2017 |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA E DRENASIT**
**Zyra e Kryetarit**
**Nr.162-4010**
**Dt:06.07. 2009**

# KONTRATË
## MBI DHËNJEN E TOKËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM.

**E LIDHUR MË DATËN 06.07.2009 NË MES :**

1. **Komunës së Drenasit të cilin e përfaqëson Kryetari i Komunës Z.Nexhat Demaku në tekstin e mëtejmë: Dhënësi i tokës në shfrytëzim.**
   **dhe**

2. **NTP "FLORIANI" Muhamet Ajazi nga Komorani Komuna Drenas (në tekstin e mëtejmë, shfrytëzuesi i tokës.**

I.

Në vështrim të nenit 14.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,nenit 2.1 të Rregullores nr.2005/13 mbi Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Shoqërore që Administrohet nga Komunat e Kosovës , Nenit 9 të Rregullores për procedurat dhe kriteret e dhënies së tokës komunale në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin e objekteve afariste në territorin e Komunës së Drenasit nr. 012-351-183 të datës 31.12.2004, Rregullores nr.031-520 të datës 04.09.2007 për caktimin e ngarkesave dhe detyrimeve dhe taksave Komunale për aplikim në territorin e Komunës së Drenasit dhe Vendimit nr.421 -3587 të datës 19.06.2009 të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës komunale, Komuna i jep **NTP "FLORIANI" Muhamet Ajazi nga Komorani** tokën në shfrytëzim të përkohshëm

me qëllim të shfrytëzimit për Afarizem .Toka e cila ipet në shfrytëzim të përkohshëm gjendet në Ngastrën kadastrale nr: 1/2 me kulturë tokë ndërtimore në vendin e quajtur "Fusha e Gjerë " zona kadastrale Komoran e evidentuar në fletën poseduese nr 187 Pasuri e Komunës së Drenasit.

II.

Toka e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm është pjesë e ngastrës nr 1/2 në sipërfaqe prej: 0.10.00 ha dhe gjendet në zonën tatimore Nr. 1 e përcaktuarë sipas Vendimit 465/49 të dt.07.02.2003 të Kuvendit të Komunës së Gllogocit për caktimin e ngarkesave dhe detyrimeve ,taksave komunale për aplikim nr.110/126 dhe ka çmimin për $m^2$ 2 € në vit . Për çdo vonesë të pagesës së qerasë do t`i shtohet kamata ditore prej 0.02 % në vlerën e përgjithshme vjetore edhe nëse pas kësaj mase nuk paguhen obligimet atëherë do të fillojnë procedurat për shkëputjen e kontratës .

III.

Toka ipet në shfrytëzim të përkohshëm për 10(dhjetë)vite, për realizimin e programit investiv të paraqitur nga ana e **NTP "FLORIANI" Muhamet Ajazi nga Komorani** dhe të aprovuar nga Komuna e Drenasit

IV.

Shfrytëzuesi i tokës me kontratë , **NTP "FLORIANI" Muhamet Ajazi nga Komorani**, pajtohet se parcelën e marr në shfrytëzim do ta shfrytëzoi sipas pikës III të kësaj kontrate dhe merr këto obligime :

1. Në këtë parcelë do të ndërtoi objektin tërësisht sipas kushteve tekniko-urbanistike dhe lejes për ndërtim që i lëshohet nga organi kompetent i Komunës së Drenasit
2. Që të filloi punën në afat prej: 3 muajsh dhe ta perfundoi mbrenda një viti
3. Që të marr lejen e ndërtimit dhe të përdorimit të objektit ;
4. Kontraktuesi i tokës , nuk mundë të ia jap të drejtën e shfrytëzimit të tokës dhe objektit një personi tjetër ;
5. Kontraktuesi obligohet që ç`do vit të paguaj qiranë për marrjen e tokës në shfrytëzim në shumë prej: **2000 €** për çdo vit, në gjirollogarinë e Komunës së Drenasit nr: 1000650070000022 kodi 40-pranë Autoritetit Bankar të Kosovës.
6.

V.

Toka i ipet me kontratë në shfrytëzim të përkohshëm për **10(dhjetë)vite**, nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate me mundësi të vazhdimit të kontratës.Palët kontraktuese kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata duke e respektuar afatin e tërheqjës prej 6 muajsh,terheqja nga kontrata ipet me shkrim.Nese paraqitet ndonjë interes i përgjithëshem për këtë sipërfaqe do të vendoset sipas legjislacionit në fuqi.

VI.

Pagesa e qirasë për token komunale të marr në shfrytëzim do të filloj **të llogaritet pas përfundimit të objektit dhe me fillimin e punës**. Nëse Shfrytëzuesi nuk i plotëson kushtet për lirim nga qiraja sipas rregullores në fuqi obligohet që qiranë ta paguan sipas Rregullores në fuqi.

Palët kontraktuese u pajtuan se çmimi për shfrytëzimin e tokës komunale sipas kësajë kontrate mund të ndryshohet nëse dhënsi i tokës në shfrytëzim e ndryshon Vendimin mbi caktimin e ngarkesave dhe detyrimeve si dhe taksave komunale pas aprovimit nga organi kompetent.Pagesa e qirasë për obliguesin, duhet të bëhet më së largu në fund të çdo gjashtëmujori, në të kundërten do të përllogaritet kamata sipas dispozitave ligjore.

VII

Shfrytëzuesi i tokës komunale i cili i plotëson kushtet sipas nenit 4 dhe 5 të Rregullorësë mbi shfrytëzimin e tokës komunale do të lirohen nga pagesa e qirasë, mirpo nëse ndërkohë nuk i përmbahet dispozitave të theksuara më lartë të kësajë Rregulloreje obligohet të paguaj qiranë për shfrytëzimin e tokës komunale sipas tarifës komunale në fuqi.Poashtu edhe shfrytëzuesit e tokës komunale të cilët me rastin e marrjës së kësajë toke nuk i kan plotësuar kriteret për lirim nga qiraja e në ndërkohë i plotësojnë këto kritere do të lirohen nga qiraja.Kjo qeshtje do të rregullohet me një aneks kontratë.

VIII

Shfrytëzuesi i tokës komunale obligohet të njoftoj Drejtorinë Komunale për Financa që i ka kryer obligimet ndaj punëtorve të punësuar lidhur me pagesën e pagave bruto , që nënkupton pagen neto së bashku me tatimin dhe kontributin.Njoftimi duhet të bëhet pas qdo periode tre mujore.

IX

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë, që pas nënshkrimit të kësajë kontrate nga palet kontraktuese të bënë regjistrimin katastral në regjistrat e paluljtëshmerive si shfrytëzues i përkohshëm i kësajë toke.

X

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshme të tokës komunale është kontratë formale që duhet të përpilohet me shkrim. Çdo gjë që nuk është paraparë sipas kësaj kontrate,do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi tokën ndërtimore,të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore .

**XI**

Shfrytëzuesi i lokacionit i bartë shpenzimet e mirëmbajtjes së rregullt të cilat janë të nevojshme për të pasur mundësi të funksionimit si dhe të paguaj shpenzimet e rrymës,të ngrohjes,të ujit dhe komunalit tjera në funksion të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të këtij objekti që do të ndërtohet në këtë tokë ndërtimore dhe pas përfundimit obligohet që tokën ndërtimore ta kthej në gjendje që e ka pranuar.

**XII**

Në rast kontesti sipas kësaj kontrate , kompetente për vendosje do të jetë Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë.

**XIII**

Kjo kontratë është e hartuar në katër ekzemplar të njëjtë prej të cilave nga dy kopje për palët kontraktuese, si dhe nga një kopje për organet kompetente.

**PALËT KONTAKTUESE :**

| SHFRYTËZUESI I TOKËS: | DHËNËSI I TOKËS NË SHFRYTËZIM |
| --- | --- |
| NTP "FLORIANI" Muhamet Ajazi | Kryetari i Komunës |
| Nga Komorani | Z.Nexhat Demaku |

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA GLLOGOC • REPUBLIC OF KOSOVO • MUNICIPALITY GLLOGOC • REPUBLIKA KOSOVA • OPSTINA GLLOGOC

Avokat / Lawyer
Kushtrim Bytyqi
Prishtinë 045 309 133

**MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOLAL**

**NGA: Muhamet Ajazi** nga Komorani, komuna Drenas, pronar i ndermarrjës **N.T.P. FLORIANI**, përmes së cilës ka lidhur raport kontraktual të shfrytëzimit të pronës komunale, me komunën e Drenasit për 10 vite.

**LËNDA: KËRKESË PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KK DRENAS PËR NDERPRERJEN E KONTRATËS PËR DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM**

**1.** Parashtruesi i kësaj kërkese është njoftuar përmes medieve se KK Drenas ka marrë vendim për ndërprerjen e vlefshmërisë së kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e ndërmarrjes së tij, e cila ishte lidhur në vitin 2009, dhe ka vlefshmëri 10 vjeçare, përkatësisht deri me dt. 06.07.2019. Mirëpo këtë vendim edhe pas interesimit në zyret komunale për tu pajisur me të nuk ka mundur të siguroj në kopje fizike. Prandaj kjo kërkesë për anulimin e këtij vendimi bazohet në kontratën nr. 462-4010, të datës 06.07.2009, pasi që nuk ka pasur mundësi që të njoftohet me arsyetimin e vendimit të atakuar, nëse ka pasur një arsyetim dhe as bazën ligjore e kontraktuale, nëse vendimi ka pasur një bazë ligjore ose kontraktuale. Po ashtu parashtruesi i kerkeses nuk ka pasur asnjëherë më parë ndonjë vërejtje, ose kërkesë për zbatimin e kësaj kontrate.

**2.** N.T.P. FLORIANI, me pronar z. Muhamet Ajazi nga Komorani, komuna Drenas, me datën 06.07.2009, kishte lidhur Kontratë mbi dhënien e tokës komunale në shfrytëzim të përkohshëm. Me anë të kësaj kontrate, përkatësisht nenit IV të saj janë të përcaktuara detyrat dhe obligimet e marrësit të tokës komunale në shfrytëzim, në mesin e tyre detyra kryesore për pagesën e qirasë në emër të shfrytëzimit të kësaj toke.

**Provë: Kontrata nr. 462-4010, të datës 06.07.2009**

**3.** Marrësi i tokës në shfrytëzim në mënyrë të rregullt ka realizuar pagesat e nevojshme të përcaktuara me kontratë në emër të qirasë për shfrytëzim, që ishte edhe obligimi kryesor i tij i përcaktuar me nenin 4 të kontratës.

**Provë: Transferet bankare në emër të qirasë**

**4.** Marrësi i tokës komunale në shfrytëzim ka pasur disa pengesa familjare për realizimin e planit të biznesit në tërësinë e tij, pasi që nga vëllai i tij kjo pronë e marrë në shfrytëzim është cilësuar si pronë familjare dhe si rrjedhojë e kësaj ka pasur vështirësi që të bëjë investimet e nevojshme dhe të planifikuara. Mirëpo këto mosmarrëveshje kanë kaluar pasi që parashtruesi i kërkesës dhe vëllezërit e tij kanë ndarë ekonominë familjare dhe tashmë jetojnë veçmas, çka do të thotë se z. Muhamet Ajazi tani është individualisht i lidhur dhe ka obligime për kontratën në fjalë, për realizimin e të cilave tashmë do të fokusohet pa ndonjë pengesë. Për këto v vështirësi që u

theksuan parashtruesi i kërkesës ka njoftuar zyrtarët komunal për mbikëqyrjen e zbatimi të këtyre kontratave në mënyrë të rregullt.

5. Duke pasur parasysh të lartshënuarat, konsiderojmë se marrësi i tokës komunale në shfrytëzim, ka një kontratë të vlefshme për shfrytëzimin e pronës komunale e cila gjendet në ngastren kadastrale nr. ½, në vendin e quajtur Fusha e Gjerë, ZK Komoran, e evidentuar në fletën poseduese nr. 187, deri me datën 06.07.2019, sipas afatit të përcaktuar në nenin 5 të kontratës. Prandaj ndërprerja e kësaj kontratë është bërë në mënyrë të kundërligjshme me anë të vendimit të Kuvendit Komunal në Drenas, pasi që shfrytëzuesi ka përmbushur obligimet sipas kontratës në lidhje me pagesën e qirasë.

Shtuar kësaj faktin se me anë të kësaj kontrate, përkatësisht në nenin 5 të saj, si arsye e vetme e përcaktuar për ndërprerjen e kësaj kontrate theksohet interesi i përgjithshëm për shfrytëzimin e kësaj parcele sipas legjislacionit në fuqi, çka do të thotë se mund të ndëprehej vetëm nëse ajo zonë do të shpallej zonë me interes të përgjithshëm shtetëror për nevoja të infrastrukturës, apo të ngjashme.

6. Përveç se kontrata e cila është ndërprerë me anë të vendimit të kuvendit komunal është e vlefshme, ekzekutimi i këtij vendimi do ti shkaktonte parashtruesit të kërkesës dëm të pa riparueshëm pasi që ka investuar në këtë pronë diku mbi 160,000.00 Euro (njëqind e gjashtëdhjetë mijë), duke lënë mbas dore edhe ekonominë familjare dhe vetë familjen, sidomos tani në kohën kur investimi do të merr formën finale dhe do të pritet të realizoj fitimin e planifikuar.

